REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 23.04.2025 Prot.37 (tridhjetëeshtatë)

Protokoll nr. 37

I mbajtur sot më datë 23.04.2025, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, e thirur me kërkesë të 1/3 të anëtarve Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);

2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

3.Kërkesë për shpalljen e gjnedjes së fatekeqësisë natyrore dhe për pasojë dëmshpërblimin e feremereve për dëmet e shkaktuara në frutikulturë pas ngricave të paprituara të dateve 7-8 Prill 2025.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Idlir Limllari; Pranvera Begolli; Dritan Çami; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Floreta Zaçe; Klea Baçi; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Eglantina Balli; Almir Elezi; Neresida Shindo; Faslli Zholi;Lulëzim Hoxhaj; Marjeta Xhelollari; Dalina Krekas; 18 (tetëmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Marainathi Avrami; Rovena Terolli; Xhuana Hoxhallari; Plator Çollaku; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Aramando Dautllari; Ilia Xhuti; Eriseld Jonusllari;Danjela Ibrahim; Server Xhuti; Andonaq Risto; 12 (dymbëedhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtori i Pronave Publike dhe Asteve; Andi Sula; Drejore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, faleminderit që i jeni përgjigjur kësaj mbeldhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, verifikojmë si fillim korumin, korumi realizohet, jemi 18 Këshilltarë

në sallë dhe mund të vazhdojmë me mbeldhjen dhe me rendin e ditës.Ju njoftoj të miratojmë rendin e ditës, por me një shtesë, të shtojmë te rendi i ditës dhe miratimin e vendimit të KQZ, për mandatimin e Këshiltares të re zj.Krisitina Malelli, nëse gjejmë dakortësinë e e Këshillit ta shtojmë te rendi i ditës këtë pjesë dhe P-V për Ndihmën e Ekonomike nga fondi 6%, duke qenë se kjo mbledhje jashtë radhe vjen afërshisht në fund të muajit.Nëse biem dakord ta shtojmë dhe Ndihmën e Ekonomike, do ishte mire, a biem dakord, ti shtojmë dhe këto dy pika?

Ornildi Demollari: Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota rendi i ditës me këto dy shtesa, Faleminderit! Dua tju kujtoj dhe konfliktin e interesit, nëse dikush nga ne ka konflikt interesi me pikat e rendit të ditës, nuk duhet të përfshihet në diskutime dhe në votim për atë pikë. Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, te kjo pikë e konfliktit të interesit, në këtë mbledhje jashtë ne kërkuam, tekamtikën që ju e bëtë prezent.E para falenderoj Kryesin, Kryetarin e ekzekutivit që u treguan të gatshëm për të zhvilluar këtë mbledhje, është një meritë e këtij institucioni që ne sot po zhvillojmë mbledhjen.Raporti qëndron te ky konflikti i interesit, që për ta qartësaur shumë me Këshilltarët, këtu përjashtohen nga ky votim, nëse do shkojmë drejt votimit, Këshilltarët që janë Fermerë? Sepse mund të jetë dhe Këshilltar dhe Fermer në investimet që ka bërë.Ka një konflikt intersi? Këtë ta sqarojë Kryetarja e Komisionit të Ligjeve dhe Mandateve.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Ajo është për procedurë, por keni të drejtë.

Yllson Ibrahimllari: Ti evidentojmë cilët Këshilltarë janë të listuar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ajo çka është kjo mbledhje, që me ti shpjegojmë Këshillit të bashkisë, cilat kanë qenë hapat që ne kemi ndjekur, për efekt të asaj që ka ndodhur nga ngricat dhe Këshilli nuk merr një vendim për këtë pjesë, pasi nuk është e drejta e Këshillit të marrë një vendim për raste të tila.Ligjëvënsi e ka parshikaur që këtë të drejtë e ka Këshilli i Ministrave, sipas propozimve që bën Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, apo Prefekti i Qarkut, sipas rastit kur bashkia çon informacionin përaktës, sipas llojit të emergjncës që ka ndodhur, ndaj doja ta shpejegoja këtë moment që Këshilli ka të drejtë të thërasë mbledhje Këshilli, për çdo situatë që ai e shikon të arsyeshme, ne do i japim Këshillit, qyetareve por dhe fermereve, se cilat janë hapat që hapat që ne kemi ndjekur për këtë situatë, por Këshilli nuk një kompetencë për të marrë një vendim për këtë qëllim.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar.Po.

Yllson Ibrahimllari: Sqarim, se po kalojmë nga pjesa tjetër, ne jemi të mendimit që këtu kemi të bëjmë me ligjin 139/2015 i ndryshuar, neni 7 ku organi në rastin konkret që po flasim, është ligji organik, kemi detyrimin dhe ligji i Emergjencave Civile, thotë në nenin e tij që përbëhemi nga dy trupa ekzekutivi dhe legjistlativi, specifika e VKM-së 158 thotë Njësia e vetëqeverisjes vendore

është ekzekutivi, është dhe Këshilli Bashkiak, si i tillë ne nuk marrim miratime, por ju sjell në vëmendje që mos, kishim shumë falenderime për punën që kemi bërë.Ne ndodhemi përballë faktit që kemi bërë një raport nga grupi i Këshilltarve që ka kërkuar këtë mbledhje jashtë radhe, kemi dhe një raport të përgatitur nga ekzekutivi mbi dëmin, që është goxha volunimoze, ne miratojmë ndihma financiare për shuma të pa përfishme këtu, në raport me dëmet që kanë ndodhur dhe si të tillë, vetë komisionet, ekzekutivi, ashtu si kemi dhe rastin që bashkë me Kryetarin e nderuar, kemi kaluar te Emergjencat Civile dhe kemi kaluar në një seancë të Këshillit Bashkiak problemin e pritave, digave të Zëmblakut dhe të Plasës, atëherë Emergjencat Civile, kërkuan një miratim në parim të saj, pra ne mund të përgatitim një relacion të saj, në ndihmë të të gjithë punës që ka bërë bashkia për tja çuar Ministrisë të linjës dhe sigurisht që vendimet nuk i marrim ne, por të miratojmë në memo, një relacion, të përballim bashkarisht të dyja palët mendimet që kemi për këtë lloj problematike dhe normalisht ndodhemi përballë faktit, ku rregullorja e specifikon më së miri, të krijohet një Komision miks, me përfaqësues të bashkisë, sigurisht që ekzekutivi ka rolin vetë, dy përfaqësues nga dy grupet, dy nga komuniteti i fermereve dhe dy nga specialsitë fushe, dy profesorë të Universiteti Bujëqsor, një i propozuar nga mazhoranca, një i propzuar nga opozita, ky është një Komision Had-Hock, që shkon dhe me atë që na ka informuar dhe Kryetari megjithse me vonesë, cili përgatit një informacion, një memo, sigurisht ndërmjet Minsitrit të linjës.Bashkia përfaqëohet, nga organi i saj përfaqësues, që është Këshilli Bashkiak, e lavdërojmë, pjesmarjen, vlersimin e dëmeve, kemi raporte të ndryshme për këtë, ne do tju propozojmë sot një projekt, për miratimin e një Komisioni të përbashkët, për vlersimin e dëmit në Frutikulturë.Ju falemiderit!

Ornildi Demollari: Falemiderit! Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Që tju shpegoj diçka, ne jemi të detyruar si ekzekutiv, të njekim gjithë procedurat ligjore, për efekt të çdo situate emergjente dhe te informacioni që ju kemi dërguar por dhe në hapat që nbe kemi ndjekur, dua të sqaroj se që në datë 07.04.2025, unë kam nxjerë një urdhër për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e situatës në terren , po në datë 07.04.2025, kanë dalë në terren, në të gjithë territorin ku ka prekur ngrica, për efekt të dëmeve në Frutikulturë, mbi situatën bazuar në ligjin "Për mbrojtjen civile" i jemi drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë në datën 11.04.202, duke i dhënë të gjithë sipërfaqen, numrin e fermereve të dëmtuar, % e dëmit të shkaktuar dhe djeni ja kemi çuar Ministrisë së Bujëqsisë dhe Zhvillimit Rural në datë 16.04.2025 dhe Agjencisë Rajonale të Eksesionit Bujëqsor, të cilat në bazë të ligjit dhe ato kanë specialistët e tyre për këtë qëllim, për të parë sitautën në vend dhe për të bërë informacionin e duhur për Dikasteret përkatëse, sipas Agjencisë Rajonale të Eksesionit Bujëqsor na shpejegohet që data 15 maj, është një datë, nga e cila ne marrim një nformacion, për situatën e dëmeve në Frutikulturë, por pavarshisht kësja ne kemi çuar informacionin tonë në Ministrinë e Bujëqsisë, po ajo që është më e rëndësishme, më datën 16.04.2025, unë i kam çuar një informacion mbi situatën e shkaktuar ngricat në Frutikulturë të bashkisë Maliq, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, i cili është institucioni bazë, i cili mund të marrë masa, mund të

propozojë, vendimmarje në Këshillin e Ministrave për shpalljen situatës emergjente dhe vetë ligji, parshikon ligji për mbrojtjen civile, në nenin 41, e drejta e kompesimit thotë, nëse dëmi shkon në nivelet 8% të buxhetit të bashkisë ai mbulohet nga bashkia, nga fondet që kemi ne për Emergjencat Civile, të dhëna nga qeveria ose të vendosura nga të ardhurat tona, për efekt kompesimi, në rastin konkret dëmi është më i madh se 8% të buxhetit të bashkisë dhe në këto kushte ne i jemi drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, duke i dhënë situatën dhe duke i shpjeguar momentin që në bazë të ligjit mund të shpallet dhe është e drejta e tyre për të bërë këtë , nuk ka të drejtë as Këshilli i Bashkisë, as Bashkia si organ ekzekutiv për të marrë hapa të tillë.Nuk parshikohet në asnjë vend që Këshilli i Bashkisë, mund të ngrejë Komisione paralele, në bazë të asaj çfarë thamë më lart, Këshilli ka kompetencat e tija, organi ekzekutiv ka kompetencat e tija, të ngrejë grupe pune, të bëjë evidentimin e situatës, ne bashkpunim dhe me Drejtorinë e Bujëqsisë në Korçë, të cilët kanë specialistët të fushës dhe për çdo rast Ministria e Bujëqsisë, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, marrin hapat e nevojshme, duke çuar në Këshillin e Ministrave një vendimmarje për këtë qëllim, dyshoj që mund të jemi në një moment pak të vështirë, jemi në kohë zgjedhjesh dhe venimmarjet për këtë qëllim, janë pak specifikedhen uk e di a lejohen ligjërisht, megjithatë institucioonet përkatse, si Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Këshilli i Ministrave ta shohin propozimin konkret për të marrë masat e duhura.A ka të drejtë Këshilli i Bashkisë tju drejtohet këtyre institucioneve? Po patjetër që ka të drejtë.Ju mund t i drejtoheni me një shkresë, duke forcuar zërin, që ne si oragan ekzekutiv kemi dërgaur te Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, apo mund tja dërgoni Këshillit të Ministrave për këtë situatë, që ata të marrin në konsidertë një kompesim, unë kam patur takim me fermerët, ata kërkojnë një kompesim të vlerave të harxhuara, jo të fitimit që mund të japë 1 dynym në frutikulturë, këto vlera shkojnë rreth 30.000 lekë për dynym.Kaq mund të shpejegoja për Këshillin e Bashkisë, nëse keni ndonjë pyejte? Kemi përfaqësues nga Drejtoria e Pronave, kemi specialistë të Bujëqsisë, mund të thresim dhe nga Emergjencat Civile, por ligjet që kanë të bëjnë me Emergjencat Civile, e saktësojnë shumë saktë dhe ne e kemi detyrim për ta ndjekur.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar.Kemi diçka tjetër? Po.

Ylson Ibrahimllari: Nuk doja të citoja, vendimi nr.158 datë 17.03.2021 vendosi:Gjendja e fatkeqësisë natyrore shpallet, kur Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga pasojat e shkaktuara, fatkeqësia, nuk janë në gjendje ta pë përballojnë atë.Organet sipas ligjit 139 2015, neni 7, organet e vetëqeverisjes vendore, përbëhet nga trupa e ekzekutivit dhe nga trupa e legjistlativit, ne po themi që ai raport që ka shkuar në Ministrinë e linjës, duhet të marrë dhe njëfarë sensibilizimi nga Këshilli i Bashkisë, jemi në ndihmë dhe në shtesë, ne jemi me tre raporte sot, ne vijmë dhe nga përvoja, ne jemi këtu për një të mirë komunitare, unë mendoj që 31 Këshilltarë këtu e njohin problematikën e komunitetit, se një grup sa do madh të jetë ai.Nisur nga kjo shkojmë te pika 6 e kësaj VKM-je, nisma për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, në raste sipas pikës 10 të ligjit, të gjithë biem dakord që kjo ishte një fatkeqësi natyrore nga

temperaturat e ulta dhe për këtë nuk kemi dyshime, mbrojten civile, ndërmeret nga Ministria e linjës sipas veçorive që shfaqen dhe fushës përgjegjëse shtetërore apo kompetencave që mbulojnë në bashkpunim me Ministrinë përgjegjëse, bazuar në informacionin e marrë nga institucionet, struktura shtetërore përaktëse dhe organet e vetëqeverisjes vendore, organet e vetëqeverisjes vendore, janë dy ekzekutivi dhe legjistlativi lokal që është Këshilli Bashkiak.Ne jemi të papërfaqësuar në këtë mendim që po vijmë, sigurisht mund të ishte raport që mund të diskutoheshe në mbledhjen e radhës, ne diskutojmë që një nga pikat që këtu preket duhet marrë dhe një farë konsultimi me Këshillin e Bashkisë, që ne nëpërjmet një memo shkojmë me Komision ose jo, kemi një raport të përgatitur nga Drejtoria e Bujëqsisë dhe nga ekzekutivi, kemi dhe një raport nga grupi që ka thirur këtë mbledhje të jashtëzakonshme, do ti hedhim në votim kush prej këtyre raporteve do i shkojë Ministrisë të linjës? Ajde ta diskutojmë.Ka nevojë për thellim?Unë them që përcaktimi i Njësisë Administrative Libonik me 53 banorë të prekur, unë them që fshati Vashtëmi bashkë me Pocestën ka më shumë qershi nga sa deklarohet, por këtë nuk e vlersoj unë.Ne jemi këtu në këtë lloj raporti, të këtij lloj diskutimi, që ky Këshill duhet të sensibilozojë organet për tu vënë në ndihmë të këtij komuniteti.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po bëjmë disktume që jemi në një mendje, nuk kemi asnjë kundërshtim, që Këshilli ti drejtohet institucioneve qëndrore për këtë qëllim, por ajo që saktësojmë, ky është vendimi 158 që ju cituat dhe thotë në pikën 4, institucionet që kanë detyrim të japin inforamcion, midis tyre është Prefekti i Qarkut dhe Bashki në territorin ku ndodh fatkeqësia, e kemi detyrim të japim informacion, gjë të cilën ne e kemi bërë, në pikën 5, për shpalljen gjendjes së fatkeqësisë natyrore sigurohen të dhë sipas pikës, institucioni që bën propozimet dhe çon këtë informacion, është Prefekti i Qarkut dhe Kryetari Bashkisë, ne si institucion e kemi bërë, Prefekti nuk di ta them por besoj e ka bërë dhe çohen të dhëna për situatën, ajo çka thashë më lart, që e parshikon ligji dhe ligji është mbi të gjitha vendimet, parshikon në nenin 41, e drejta e kompesimit, shteti Shqipëtar përgjigjet për dëmet nga fatkeqësi, nëse do quhet e tillë nga Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, spese ao e verifikon dhe e vendos nëse është e tillë apo.Në prizimin tim po, unë e ka çua të jetë një gjë e tillë, që të kompesohen ata nga shteti dhe në pikën 3, thotë në raste se bashki nuk ka fonde të mjaftueshme për kompesim, atëhere ato planifikohen në vitin pas ardhës deri në momentin e kompesimit të subjekteve të dëmtuara, në rast se vlera e kompesimit tejkalon 8% të buxhetit të bashkisë , atëhere AKMC-ja vendos që kompesimi, të kryhet nga AKMC-ja me fondet e qeverisë Shqipëtare, kjo është ajo që përcakton ligji për mbrojtjen civile, por që ta mbyll nuk mund të mohj një të drejtë që e ka Këshilli, që ti drejtoheni çdo lloj institucioni për këtë situatë dhe të jemi në një linjë bashkë me ekzekutivin dhe nuk kemi asnjë kundërshti në këtë linjë.Këshilli i Bashkisë ti drejtohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për djeni Këshillit të Ministrave për këtë situatë dhe për nevojën për kompesim të Fermereve që janë dëmtuar nga ngricat në datat 6-7 Prill.

Petrit Kupe:Më duket se gjithë ky debat që bëhet pavarsisht se ka një moment vonese, që ngrenë kolegët e opozitës, mbështetja nga bashkia duhet të ishte bërë në të njëjtin moment njëjtin moment që është bërë dhe vlersimi nga ana e bashkisë, megjithatë unë di që ka disa afate nga momenti i dëmit deri në konstatim, afate 10 ditore që dërgohen në organet kompetente të cilat vihen në djeni është faza e parë, kjo fazë është respektuar, do ishte më e arsyeshme që dhe Këshilli të ishte në mbështetje në të njëjtën kohë, të bëhet dhe një relacion nga Këshilli për tu dërguar te organet kompetente, vlersimi të bëhet nga specialistë dhe nuk pse të jemi ne si Këshiltarë në Komision, por në momentin e miratimit të dëmeve dhe vlerave do miratohen përsëri nga Këshilli, uroj që organet kompetente ta marrin parsysh sa më parë dhe vlersimi i dëmit që është i dukshëm pas përfundimit të çeljes të furitikulturës, të bëhet sa më parë që dhe komuniteti ti përfitojë këto ndihma.Këto doja të thoja.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Po.

Lulëzim Hoxhaj:Përshëndetje! Për qartësim, unë mendoj që ky diskutim që po bëhet, pak a shumë ne jemi në një linjë.Por ka diçka që dua ta theksoj, plotësisht dakord sipas ligjit, shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, e shpallin Emergjencat Civile, unë mendoj që në këtë moment ne jemi në kushtet të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, vetë nga relacioni dhe unë besoj sa ai relacion është kokrekt dhënë nga speciaslitët e bashkisë Maliq, përfshin rreth 800 familje të dëmtuara nga ngricat dhe rreth 600 ha.Vetëm me këtë fakt, 800 familje sikur të llogaritim 10.000 lekë dëm për çdo familje shkon shifra rreth 100 milon lekë të vjetra, me këtë shifër jemi në kushet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sepse bashkia e Maliqit nuk e përballon dot me fondin rezervë që ka në dispozicion për Emergjencat Civile.Nuk e shpall Këshilli Bashkiak gjendjen e fatkeqësisë natyrore, por institucionet përkatse, ne jemi të interesuar që kjo të shpallet, sepse kjo ekzisiton, është e vërtetë, prandaj këtu është diskutim.Një realacion ose akt, i miratuar nga ky Këshill dërguar institucioneve përkatse, unë mendoj që i bën mirë kësaj situate dhe ju vjen në ndihmë fermereve, sepse unë mendoj që dëmi është shkaktuar dhe nuk ka nevojë, as për 15 ditë dhe as për çeljen e dytë, mund të ketë diferenca në % e dëmit, për këtë biem dakord, por që dëmi është i tillë dhe nuk e përballon dot bashki dhe jemi në kushtet e gjendjes të jashtëzakonshme, ky është fakt sot dhe propozimi që bëri Yllsoni, ngritjen e një Komisioni, mendoj që është brenda ligjit dhe mendoj që ky Komisioni do ta ndihmonte shumë këtë proces dhe do e shpejtonte këtë proces, më mirë se ky Komisoin i ngritur nga Këshilli Bashkiak, nuk mund të bënte vlersim më të saktë se sa një Komision i ngritur nga Emergjencat Civle, që të vijnë të vlersojnë situatën dhe ata, le të vijnë ta bëjnë dhe ata, por mendoj që ky Komision sipas propozimit që u bë këtu ja vlen dhe do e ndihmojë shumë situatën.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Megjithë respektin që ka për çdo Këshilltar, çfarë do bëni ju vlersim dëmi? Kur këtë duhet ta bëjnë Agronom të bujëqsisë të bashkisë, Agronomë të Eksesionit Bujëqsor Rajonal Korçë, këta e kanë detyrim ligjor dhe ata duhet të përballen me Fermerët për saktësinë e e veprimeve etj.Jemi në kohë fushate dhe merr ngjyra të tjera se kush do

jetë mëafër njerzeve se kush do jetë më afër për këtë punë mua më duket jo normale.Që ne tju jemi afër këtyre Fermerve që kanë hedhur djersën e tyre atje, jam shumë dakord dhe Këshilli të dalë me një dokument tja dërgojë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Prefekti të Qarkut Korçë dhe Këshillit të Ministrave, për këtë jam shumë dakord, por çfarë do bëjnë anëtarët e Këshillit? Do bëjmë mbivendosje institucionesh, ai Agronomi e ka detyrim ligjor dhe duhet të mbajë përgjegjës për veprimet që bëjnë, nëse ju keni dyshime në këtë punë.

Lulëzim Hoxhaj: Sot që flasim, jemi në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nuk e ndajmë dot ne, por në konceptin tim, po.Unë e kam bërë shkresën, ku ju kërkoj të dërgojnë grupoe ta evidentojnë situatën dhe ti propozojnë Këshillit të Ministrave, këtë sitautë.Nuk e ndajmë dot ne sot ligjërisht.

Lulëzim Hoxhaj: Sot që flasim, kemi ndonjë gjykim për situatën?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Sot që flasim, nnuk mund të japim ndonjë gjykim sepse lulet janë tharë, ajo çka shiheshe, shieshe ditën që e kemi parë ne, sepse ajo bëhet në atë moment.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem! Kemi dy raporte, a mund ti dëgjojmë? Të Bujëqsisë dhe raportin e Këshilltarve të Opozitës dhe e dyta nuk po bëjmë fare fushatë, unë nuk jam përfshirë në fushatë, Drejtoria e Bujëqsisë ka një detyrim ligjor karshi nesh, ashtu si e ke dhe ti, nuk duhet ta anashkalosh trupën e zgjedhur, Këshillin Bashkiak.Kur e ke bërë raportin tja kishe dërguar me e-mail dhe Këshillit dhe në bënim një rezolutë në mbështetje të njëri tjetrit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ligji dhe VKM-ja nuk e përcaktojnë këtë detyrim, për tja sjellë Këshillit Bashkiak, Këshilli i Bashkisë, ka të drejtën të marr vendim kur të vijnë fondet, për ti shpërndarë ato.

Yllson Ibrahimllari: Kam një pyetje për drejtorin e bujëqsisë që kemi mbrapa, vlera e dëmit është më shumë se 4% që ne miratojmë nga buxheti i shtetit për Emergjencat Civile? Është dhe ndodhemi përballë faktit, që ka ndoshur një fatkeqësi natyrore, Këshilli ka të drejtë të ngrejë Komisione për çfarë të dojë, ne kemi Agronomë që kanë dalë në terren me komunitetin, dy Agronomë kemi ne te grupi jonë.Ne nuk kemi qëllim për fushatë.Faleminderit!

Faslli Zholi: Faleminderit Këshilltarë! Faleminderit Kryetar!Faleminderit pjesmarës! Ne që kërkuam këtë mbledhje nuk e kërkuam për fushatë, por e kërkuam duke patur dhe kontakte në terren, kishim ankesa nga me hektarë në fshatin Pocestë, Leminot dhe e kërkuam këtë në bazë të rregullores të Këshillit Bashkiak, për të bërë këtë mbledhje dhe falenderoj Kryesinë dhe Këshilltarët që morrën këtë iniciativë dhe po zhvillohet kjo mbledhje.Duhet të ishte mbledhur Komisioni i Bujëqsisë që unë kryesoj, shikoj që ka anomali, sidons nga krahu i mazhorancës nga Këshilltarët, Këshilltari duhet të ketë rregull, të zbatojë ligjin dhe duhet të paraqitet kur mblidhet Komisioni, sepse për më tepër kjo është fatkeqësi natyrore dhe Këshilltari duhet të ndjejë veten, unë isha dakord që mbledhjen ta zhvillonim dhe ditë pushimi, kur ka raste si ky, por ju falenderoj

që e miratuat për ta bërë këtë mbledhje.Po dua të them që njerzit që janë dëmtuar, kanë frikë të shprehen dhe nuk bëjnë ankesë, nuk e kuptoj kur kanë aq dëme nga prona e tyre dhe ngurojnë të shprehen, nuk kanë besim se Bashkia Maliq, Prefektura, mund të kenë bërë letrat, por njerzit nuk kanë marrë asnjë kompesim dhe kanë pakënaqësi, këtu kemi dhe përfaqësues nga Fermerët dhe mbase do thonë diçka.Unë dua të them dhe diçka për Komisionet z.Kryetar, mos më thuaj,nuk vijnë se nuk kanë mundësi, Komisionet janë Komisione dhe duhet të funksionojnë sepse këtë e përmban ligji, kush nuk vjen të japi dorëheqjen.Ju faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Mund të them unë atë që mendoj, është në sintezë kësaj që po diskutojmë.Dua të saktësoj momentin, nuk thashë që po e bëni këtë për fushatë elektorale, por nëse dalim me Komisione në fusha, jemi në një situatë zgjedhjesh dhe mund të keqpërdoret, që 1/3 e Këshilltareve kanë të drejtë të thrasin mbledhje jashtë radhe, po patjetër dhe ne nuk kemi dyshim për këtë pjesë, ndaj është bërë dhe kjo mbledhje sot, kemi rënë dakord, kemi dhënë dhe informacion.Nuk thuhet në asnjë pikë që kur ndodh një situatë e tillë, duhet të thras Këshillin ose duhet ta informoj atë, kështu e thotë ligji.Ligji më detyron të bëj ato çfarë thashë më lart dhe e kam zbatur në mënyrë korekte dhe jma dakord me ju për shqetësim që ngrini është edhe i imi, unë kam takuar fermerë në disa fshtra dhe kam marrë një situatë të tillë dhe në bazën e tyre ju kam informuar çfarë kam bërë unë me hapat e nevojshëm dhe i jam drejtuar të gjitha institucioneve për këtë qëllim, këtë kam bërë unë, po ja ushpjegoj dhe ju dhe jemi në pritje të vendimmarjes që do marrë Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile që e kam ligj dhe Këshilli i Ministrave do e shpalli dhe do i kompesojë këta fermerë dhe ajo.Agjencia përkatse në Korçë na ka thënë që afati për vlersim është 15 Maj, ku mbaron faza e lulëzimit dhe ne shpallim sa është përqindja e dëmit.Institucionet përaktëse që i detyron ligji e kanë për ta bërë, kaq mund tju shpjegoj, pastaj se çfarë vendim merr Këshilli, kjo është e drejta juaj, nuk ju ndërhyj në këtë pjesë.Ajo çfarë them është, ju duhet të bazoheni në ligj dhe çfarë kompetenca keni, mos kemi mbi vendosje te njëri tjetri, nuk asgjë jeni të mirëpritur, që të bëheni pjesë e punës tonë, ju vetëm ju por dhe fermërët, nuk kemi çfarë të fshehim.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar!Po.

Faslli Zholi: Ky materiali që keni bërë brenda bashkisë, të ishte konsultuar dhe me ne, sepse kur kemi patur një fatkeqësi, si prsh një varrim kemi miratuar 500 mijë lekë, këtu kemi 1 milardë lekë dëmë dhe nuk bëjmë asgjë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ne nuk po miratojmë fonde, do ishte më mirë edhe pse ligji nuk e parshikon, që këtë informacion, tja u kishim sjellë dhe ju dhe ishim në rregull.

Ornildi Demollari: Kur nuk e parashikon ligji, nuk keni pse e sillni.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ne nuk po miratojmë vlera, në momentin që do kemi vlera, ju do i miratoni, që ta mbyll si moment, të shpresojmë që Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ta marrë në konsideratë këtë kërkesë dhe fermerët të ndihmohen ,që të

kompesohen, sepsë është mundi i tyre, jo vetëm i këtij sezoni, por ato japin ndikim edhe vitin tjetër.

Ornildi Demollari: Ta mbyllim këtë diskutim, jo ju lutem.

Lulëzim Hoxhaj:Në rast se kemi të bëjmë me një fatkeqësi natyore, shteti është i detyruar ti kompesojë 100%?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Po patjetër.

Ornildi Demollari: Që ta mbyllim këtë diskutim, sensibilizohemi të gjithë me fatkeqësinë që goditi kulturat bujëqsore të bashkisë tonë dhe le të shpresojmë që Agjencia Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ta vlersojë, të reagojë dhe pse jo ti dëmshpërblejë fermerët dhe e mbyllim këtu këtë diskutim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Unë do sygjeroj që këshilli të dalë me një dokument, duke ja drejtuar të gjitha instancave.

Yllson Ibrahimllari: Kjo mbledhje është thirur nga një grup prej 1/3 e Këshilltarve, Kryetari doli në konkluzionin e vetë, ju shumë mirë bëtë në sensiblizimin, por unë mendoj që ky Këshill i kapacitetet, i ka mundësitë, me një Memo, me një Rezolutë, me një mbështetje, të vlersojë gjendjen dhe tju bëjë thirje organeve kompetente për zbatimin e saj, por vlen edhe një gjë, sa do hapsira ose mos hapsira të japë ligji, ne jemi një trupë e njësisë të vetëqeverisjes vendore, ekzekutivi ka rolin e vetë, nëse sthotë që kryetari duhet ta pyesi, e thotë neni 7 i ligjit 139/2015 i ndryshuar, ekzekutivi dhe legjistlatvi, nëse nuk thotë ne kemi bërë gjëra të mira në çdo hohë, kur kemi dashur dhe kemi patur vullent, e kemi pyetur njëri tjetrin, ndoshta ka dhe vlerë më shumë me sensibilzimin përaktës.Unë e kuptoj që dhe për sa i përket, kështu që ta diskutojmë sot parprakisht, ky Këshill duhet të dali sot ose në mbledhjen e radhës me një Memo, me një Rezolutë drejtuar organeve sipas ligjit.Të mirtuar në parin nga ana jonë dhe pastaj të ndjekim ecurinë, sepse në rastin e e Zëmblakut dhe të Plasës disa vite më parë ne bashkë e kemi ngritur dhe ju keni qenë iniciatorë kur kemi thënë për breshrin në Shëngjergj, që para një viti u dëmtuan prodhimet dhe në Podgorie dhe në Shëngjergj, Pojan dhe duke mos patur këtë klauzolë ligjore nuk arritëm ti shpërblejmë, kemi folur dhe për siguracione në atë kohë.Jemi këtu do e përgatitë këtë Memo, këtë Rezolutë Komisioni i Bujëqsisë? I.e ta sjellë, le të mblidhet Komisioni i Bujëqsisë, ta sjelli.

Ornildi Demollari: Gjykoj që Memon që ka përgatitur bashkia, ta miratojmë apriori, sepse nuk është P-V, mund ti shtojmë ose ti heqim diçka.

Yllson Ibrahimllari: Dashurinë e madhe që kemi për ekzekutivin duhet ta frenojmë pak, ne si Këshill kemi kapcitete për të formuar një qeveri. Ligji nuk e pengon Këshillin bashkiak të dali me një Relacion.Relacioni i ekzekutivit është i mangët, nuk ka referenca për vlerat ekonomike.

Ornildi Demollari: Atëhere urdhro dhe sill propozimin se çfarë duhet shtuar.Po thua që të ngremë një Komison nga Këshilli?

Yllson Ibrahimllari: Jo Komison, ky Këshill të dali me një Memo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kemi mundësi dhe si Këshill dhe si ekzekutiv ta bëjmë këtë dokument dhe tja nisim Institucioneve, nëse do keni nevojë dhe për ne jemi të gatshëm.

Yllson Ibrahimllari: Ne kemi nevojë të na dëgjoni.Faleminderit!

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Shumë faleminderit Këshillit!

Almir Elezi: Meqenë se jemi te bujëqsia, dua të ngre shqetësimin për tokat e zëna, blegtorët nuk kanë mundësi të kulloton bagëtitë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Jemi duke u marrë me këtë shqetësim, për këtë qëllim kam lënë takim me të gjithë blektorët që janë bërë problem në fushë në Podgorie, të cilve do ju kërkoj të kullotin bagëtitë vetëm në pjesën malore, do lirojmë gjithë sipërfaqet e zëna me forcë, do kërkojmë dhe mos hyjnë bagëtitë në fushë.Ta stabilizojmë situatën në të mirë të gjithëve.

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar!Për korektësi dy zotërinjtë kanë diçka për të shtuar si fermerë?

Qytetari: Ngre shqetësimin në emër të fermereve për dëmet në bujëqsi.A janë marrë cerftifikat e pronësisë në tokat e Maliqit dhe dyta a kanë shkuar investimet e bashkisë në vendin e duhur?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Do i kërkoja lejë Këshillit se kam një angazhim tjetër, do jem dakord me atë dokument që do nxjerrë Këshilli.

Pranvera Begolli: Te disa bashki të tjera, për familjet Rome ose Egjptiane që kanë fëmijë në shkollë, marrin bursa, do doja që zyra e Ndihmës Ekonomike ta aplikonte dhe këtu në bashkinë tonë.

Ornildi Demollari: Faleminderit I japim lejë Kryetarit dhe ne vijomë me dy pikat e tjera.Pika e parë që dakrtësuam është miratimi i vendimit të KQZ për dhënien e mandatit të Këshilltres të re pas vakancës të krijuar.I jap fjalën Kryetares të Komisionit të Mandateve për të prezantuar raportin.

Pranvera Begolli: Faleminderit Kryetar! Komisioni i Mandateve i mbledhur ditën e djesshme, duke shqyrtuar dhe materialin e erdhur nga KQZ, hartoi raportin.

Në zbatim ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015*"Për vetëqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, neni 49 *"Mandati i këshilltarit"* pika 1 dhe 2, neni 54 "*Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak"* gërma "j" dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "*Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë*

Maliq", neni 172 *"Marrëdhëneit e këshillit me KQZ"*, dhe duke u bazuar në shkresën me nr.2336 prot., datë, 31.03.2025 të Komisoneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KQZ) Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënine e manadit, protokollar pranë bashkisë Maliq me datë 02.04.2025 si dhe vendimit nr.330 i KQZ Tiranë, datë 28.03.2025 *"Për plotesimin e vakancës në këshillin e bashkisë Maliq, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë"*, zj.Kristina Pertef Malelli, dalë nga zgjedhjet për qeverisjen Vendore të datës 14 Maj 2023.

Nga verifikimet e dokumentacionit, komisioni vërtetoi se mandati është fituar konform kërkesave të Kodit Zgjedhor dhe ligjit 139/2015 *"Për Vetëqevertisjen Vendore"* i ndryshaur. Ndaj i propozojmë këshillit bashkiak ,

1- Miratimin e raportit për dhënien e mandatit të këshilltarit zj.Kristina Pertef Malelli kanditatë në listen shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", përgatitur nga Komsioni i Mandateve.

2- Sekretari i Këshillit të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore.

I mbajtur sot më datë 22.04.2025 në Bashkinë Maliq, nga Komisioni i Mandateve të Këshillit të Bashkisë Maliq, i zgjedhur në mbledhjen e tij të parë i përbërë nga:

Ornildi Demollari: Faleminderit! E kajomë në votim raportin?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota raporti, Faleminderit! Kalojmë te formula e betimit.

Pranvera Begolli: Teksti i betimit:

"Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Maliq dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre".Faleminderit!

Kristina Malelli: Betohem!

Ornildi Demollari: Faleminderit! Suksese koleges.Kalojmë te pika e fundit që kishim për sot, P-V për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi 6% për muajin Mars 2025.Kush e do fjalën? Ermanda ke diçka për të shtuar këtu? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota , Faleminderit!

Yllson Ibrahimllari: Kemi një vakum ligjor, duhet të zgjidhni Kryetarin e grupit dhe njëkohësisht me votim të fshehtë përfaqësuesin e Këshillit në Qark.

Ornildi Demollari: Të nderuar kolegë, këto ishin pikat e rendit të ditës, ju falenderoj dhe ju uroj ditë të mbarë në vazhdim.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI